

Korpusi i Paqes Shqipëri

RAPORTI VJETOR 2018

148 Vullnetarë të Korpusit të Paqes
+ 68 Komunitete
= 22,842 Shqiptarë që u është shërbyer



Mesazh nga E Ngarkuara me Punë e SHBA Leyla Moses-Ones

Të dashur vullnetarë, qytetarë shqiptarë, dhe personel i Korpusit të Paqes:

Në të gjithë Shqipërinë ka kryetarë bashkish të angazhuar, drejtorë të shkollave, udhëheqës të OJQ-ve, prindër, mësues dhe udhëheqës qytetarë të cilët punojnë shumë çdo ditë për t'i bërë komunitetet e tyre më të forta, më të jetueshme dhe më të begata. Ata mishërojnë parimin që, çdo ditë, ndryshimet e vogla mund të çojnë në ndikime të mëdha. Këta udhëheqës të angazhuar tek baza e qytetarëve shpesh punojnë krah për krah me vullnetarët me të njëjtin pasion të Korpusit të Paqes, të cilët po japin ndihmë teknike dhe po ndërtojnë bazuar mbi pikat e forta që tashmë ekzistojnë në komunitetet e tyre përkatëse. Vitin e kaluar, unë isha dëshmitare e fuqisë së këtyre partneriteteve të frytshme të ndërtimit të kapaciteteve.

Në vjeshtën e vitit 2018, kisha rastin të vizitoj zyrën e Korpusit të Paqes kur ambasada e SHBA ishte duke pritur një vizitë të Krye Zëvendës Ndihmës Sekretares së asaj kohe Elizabeth Millard. Gjatë kësaj ngjarjeje dinamike, u takuam me tre vullnetare të Korpusit të Paqes, disa udhëheqëse mbresëlënëse të komuniteteve shqiptare dhe një grup të shkëlqyer të të rejave që janë vajza skautiste. Ta shikoje në mënyre direkte punën që vullnetaret dhe udhëheqëset shqiptare të komuniteteve po bënin për të ndërtuar besimin, kurajon dhe karakterin e rinisë shqiptare, ishte mbresëlënëse dhe frymëzuese. Ky ishte vetëm një shembull i asaj që ka ndodhur në 68 komunitete përgjatë gjithë Shqipërisë, duke ndikuar në 22,842 individë.

Udhëheqësit e fuqizuar frymëzojnë dhe i japin energji të tjerëve të veprojnë - dhe momenti i kësaj force motivuese vazhdon t'ia "shpërblejë me punë të tjerëve." Të qenit dëshmitarë të kësaj duhet të na bëjë të gjithë ne, të ngazëllyer për rritjen e vazhdueshme të këtij vendi të pabesueshëm.

Urime për të gjithë ata që kanë kontribuar në punën mbresëlënëse reflektuar në këtë raport vjetor.

Sinqerisht,

Leyla Moses-Ones
E Ngarkuara me Punë e SHBA



Mesazh nga Drejtoresha për Shqipërinë Kate Becker

Përsëritje,

Korpusi i Paqes është krenar për të shërbyer në Shqipëri dhe ne jemi të kënaqur të ndajmë me ju Raportin tonë Vjetor të 2018.

Ky Raport Vjetor përmbledh punën tonë në vitin 2018, duke ndarë me ju numra, citime dhe tregime të rëndësishme që enden së bashku si në një qilim tradicional shqiptar. Mësimdhënia e gjuhës angleze dhe e shëndetit brenda dhe jashtë klasës, trajnimet mbi biznesin dhe udhëheqjen, projektet mbi shtigjet malore turistike, aktivitetet fizike dhe sportive, programet e turizmit, trupat e Vajzave Skautiste, mbjellja e pemëve, konkurset “Të Shkruajmë”, aktivitetet sipas “Modelit të Kombeve të Bashkuara”, ndërtimi i banjove, dhe krijimi i bibliotekave dhe pikturave murale si edhe organizimi i kampeve verore janë disa shembuj të punës që po bëjnë Vullnetarët dhe homologët e tyre. Ne gjithashtu e kuptojmë se kjo sapo fillon të tregojë historinë tonë dhe nuk kap tërësisht ndikimin tonë të plotë.

Miqësitë personale dhe mirëkuptimi global përmes shkëmbimit në bashkëpunim të kulturave tona përkatëse është pjesa tjetër e historisë së punës sonë, që është shumë më e vështirë për tu treguar. Së bashku, SHBA dhe Shqipëria po thyjnë barriera, duke ndërtuar dashuri, respekt dhe besim. Kjo është ndoshta aty ku ndikimi i vërtetë i Korpusit të Paqes në Shqipëri mund të kuptohet më së miri.

Të dhënat, tregimet dhe citimet e gjetura në këtë Raport Vjetor pasqyrojnë talentin dhe energjinë e Vullnetarit të Korpusit të Paqes, të homologëve shqiptarë, agjensive të tyre të punës, stafin e Korpusit të Paqes, të rinjtë dhe komunitetet të cilët përpiqen të kenë një ndikim këtu në Shqipëri. Bravo për secilin nga ju që keni dhënë kohën tuaj për ta bërë Shqipërinë tonë, Shqipërinë më të mirë mund të jetë.

Në shërbim,

Kate M. Becker
Kate M. Becker

Drejtoreshë e Korpusit të Paqes në Shqipëri



Misioni dhe qëllimet e Korpusit të Paqes

Në vitin 1961, Presidenti i Shteteve të Bashkuara, John F. Kennedy, themeloi Korpusin e Paqes për të ushqyer të kuptuarit më mire mes tyre dhe për të nxitur miqësinë ndërmjet amerikanëve dhe popujve të vendeve të tjera.

Misioni i Korpusit të Paqes është të nxisë paqen në botë dhe miqësinë, duke përmbushur tre qëllime:

1. Të ndihmojë popujt e vendeve të interesuara, që të përmbushin nevojat e tyre për burra dhe gra të trajnuar.
2. Të ndihmojë në nxitjen e kuptimit me te mirë të amerikanëve nga popujt të cileve u sherbehet.
3. Të ndihmojë në nxitjen e kuptimit me te mirë të popujve të tjerë nga ana e amerikanëve.

Korpusi i Paqes ndryshon jetë, jetët e njerëzve në komunitetet rreth botës dhe jetët e vullnetarëve.

- Në Korpusin e Paqes kanë shërbyer më shumë se 235,000 amerikanë në 141 vende të botës.



Korpusi i Paqes Shqipëri

Në vitin 1991, Qeveria Shqiptare ftoi Korpusin e Paqes për të themeluar një program brenda vendit. Grupi i parë i vullnetarëve mbërriti në vitin 1992, duke u marrë dy vjet me mësimdhënien e gjuhës angleze në shkollat e mesme dhe në universitete. Nga viti 1993 deri në vitin 1996 mbërritën katër grupe vullnetarësh shtesë, për mësimdhënien e gjuhës angleze, mbështetjen e zhvillimit të bizneseve të vogla, ose mbështetjen e menaxhimit të bujqësisë dhe pyjeve. Korpusi i Paqes e mbylli programin e tij në Shqipëri në vitin 1997 për shkak të trazirave politike dhe shqetësimeve për sigurinë e vullnetarëve.

Në vitin 2002, qeveria Shqiptare e ftoi Korpusin e Paqes për të rihapur një program dhe mori pjesë në një vlerësim të kryer nga Korpusi i Paqes. Ne baze të këtij vlerësimi, pjesëtarët e parë të stafit të Korpusit të Paqes mbërritën në Shqipëri në mars të vitit 2003, për të ngritur një zyrë dhe për të rihapur programet.

Që prej vitit 2003, vullnetarët kanë punuar me qeveritë vendore, OJF-të, shkollat dhe institucionet shëndetësore, në tre fusha të projektit:

- Mësimdhënie e gjuhës angleze
- Edukimi shëndetësor
- Zhvillimi i komunitetit dhe organizimit

Programi i Korpusit të Paqes është rihapur me ftesë të Qeverisë Shqiptare dhe operon sipas marrëveshjes ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë, që njeh rëndësinë e zhvillimit të marrëdhënieve të përfitimit reciprok dhe bashkëpunimit.

Që prej vitit 1992, 871 vullnetarë kanë punuar në Shqipëri.





Korpusi i Paqes Shqipëri në vitin 2018

"Miq të e mi në shtëpi mendojnë se unë po ndryshoj botën. Kolegjet e mi shqiptarë mendojnë se po ndryshoj Shqipërinë. Ajo që po ndodh është se Shqipëria po më ndryshon mua."

VKP Terri,
Durrës



- 148 vullnetarë të Korpusit të Paqes (VKP)
- 3 sektorë
 - Mësimdhënie e gjuhës angleze
 - Edukim shëndetësor
 - Zhvillimi i komunitetit dhe organizimit
- Të vazhdohet partneriteti me bashkitë, ministritë dhe OJF-të, dhe kalimi i emërimeve në komunitete më të vogla, që kanë më pak burime;
- Theksim i shtuar i çështjeve mjedisore, zhvillimit të turizmit dhe qëndrueshmërisë së projekteve përmes mbështetjes dhe pronësisë vendore.

Ju prezantojmë vullnetarët e Korpusit të Paqes në Shqipëri




Vullnetarët e Korpusit të Paqes vijnë nga të gjithë anët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për të sjellë një ndryshim në nivelin e bazës së njerëzve në Shqipëri. Vullnetarët shkëmbejnë vlerat dhe perspektivat e tyre të origjinës me komunitetin pritës në të cilin shërbejnë, një shkëmbim ndërkulturor që sjell paqe dhe miqësi.



“Vullnetari ynë Nic ynë është një djalë me të vërtetë i këndshëm. Ai na ka ndihmuar shumë. Ai ndërtoi një bibliotekë të re për shkollën tonë. Na ndihmoi me shumë aktivitete në shkollën tonë dhe na ndihmoi të përmirësohemi edhe me anglishten. Ai është sjellë mirë me të gjithë dhe ka qenë një shok i mirë për ne.”

*Ervini,
Student,
i Klasës 12 Krumë*

Ju prezantojmë vullnetarët e Korpusit të Paqes në Shqipëri



“Zemra dhe shpirti i Korpusit të Paqes janë vullnetarët e saj. Është kaq mbresëlënëse që vullnetarët janë aq unikë dhe të ndryshëm nga njëri-tjetri, por aq të ngjashëm në ndarjen e kulturës dhe përkushtimit të tyre ndaj komuniteteve që u shërbejnë.”

Sara punoi me 2 VKP në Përmet, Barb dhe Laurelin.

2


Vullnetarë
u bënë qytetare amerikane
me qëllim që
ti bashkohen
Korpusit të Paqes

3



VKP kanë shërbyer si
VKP më parë!

Mary Lou Surgi, Malajzi, 1978-1980
Marilyn Matt, Armeni, 2008-2010
Mike Bailey, Kinë, 2013-2015

ARSIMI



Ju prezantojmë vullnetarët e Korpusit të Paqes në Shqipëri



Gjuhët

Anglishtja nuk ishte
gjuha amtare e

8%

të të anketuarëve*

47%

e të anketuarëve
flasin 1 gjuhë
tjetër, përveç
gjuhës angleze dhe
gjuhës shqipe

8 të anketuar* flasin 2 gjuhë të tjera shtesë

1 i anketuar* flet 3 gjuhë të tjera shtesë

i të anketuarve* me familjarë që kanë qenë ose janë Vullnetarë


• Prind	1
• Fëmijë	1
• të afërm	1
• Kushëri	1
• Shok ose koleg të afërt	26

* I referohet një anketimi të Vullnetarëve, që punuan në Shqipëri në 2018, në të cilin 50% e plotësuan anketimin.

Ju prezantojmë vullnetarët e Korpusit të Paqes në Shqipëri



Pas shërbimit të Korpusit të Paqes, si po planifikojnë vullnetarët që ti çojnë përpara në jetët e tyre idealet e Korpusit të Paqes?




“Në kohën e shkurtër që kam kaluar duke jetuar në komunitetin ku punoj gjatë shërbimit në Korpusin e Paqes, kam ndërtuar marrëdhënie të shumta të ngushta që do ti çmoj për gjithë pjesën tjetër të jetës sime.”

VKP Kellen,
Rrethi i Beratit

Ju prezantojmë vullnetarët e Korpusit të Paqes në Shqipëri



Përveç ndarjes së kulturës së Shqipërisë përmes tregimeve, si planifikojnë vullnetarët të prezantojnë Shqipërinë tek Amerikanët kur të kthehen në shtëpi?



- Ndajnë me shokët dhe familjen muzikën, filmat dhe kulturën shqiptare.
- Shkruajnë blogje ose artikuj rreth Shqipërisë.
- I bashkohen grupit "Miq të Shqipërisë" ose grupeve të tjera të ish-vullnetarëve.
- Të tjera, përfshirë diskutime në shkolla dhe aktivitete rreth festave shqiptare

"Familja ime pritëse ka qëndruar pranë meje gjatë dy viteve të fundit, duke përjetuar të gjitha uje ngritjet me mua. Pa mbështetjen e tyre të palëkundur, unë nuk do të isha aty ku jam tani. Ata nuk janë më familja ime "pritëse" - ata janë thjesht familja ime tashmë."

VKP Malia
Bilisht

Synimet e vitit 2018 sipas sektorëve



Edukimi shëndetësor

1: Shëndeti seksual dhe riprodhues

Të rinjtë do të përvetësojnë sjellje dhe praktika që kontribuojnë në shëndetin e përmirësuar seksual dhe riprodhues.

2: Mënyrat e shëndetshme të jetesës dhe aftësitë për jetën

Të rinjtë do të përvetësojnë aftësi për jetën, që janë të nevojshme për të marrë vendime të përgjegjshme dhe të shëndetshme, dhe të bëjnë veprime, që ndikojnë pozitivisht në jetën e tyre dhe në jetët e njerëzve përreth tyre.



Zhvillimi komunitar dhe organizativ

1: Zhvillimi organizativ

Organizatat vendase dhe grupet komunitare do të fuqizojnë aftësitë dhe proceset menaxheriale/operacionale dhe organizative.

2: Ndërtimi i Shoqërisë Civile

Individët do të rrisin kapacitetin e tyre për të marrë pjesë në shoqërinë civile vendore dhe në zhvillimin e komunitetit.

Mësimdhënie e gjuhës angleze

1: Përmirësimi i mësimdhënies

Mësuesit dhe udhëzuesit e gjuhës angleze do të përmirësojnë zotërimin e gjuhës angleze, metodat e mësimdhënies dhe aftësitë për zhvillimin e burimeve.

2: Rritja e suksesit të studentëve

Studentët do të mund të përmirësojnë zotërimin e gjuhës angleze, komunikimin, dhe aftësitë për jetën përmes udhëzimit për gjuhën angleze në klasa ose përmes veprimtarive jashtëkurrikulare.

3: Fuqizimi i shkollës dhe i komunitetit

Mësuesit, stafi i shkollës dhe administratorët, dhe anëtarët e komunitetit të gjerë do të forcojnë bashkëpunimin dhe do të jenë pjesëmarrës më aktivë dhe lidera të shkollës së komunitetit të tyre.

Studentët dhe Bashkia Zbukurojnë Liqenin dhe krijojnë Kopshte

Pjesë nga projekti



Zhvillimi Komunitar & Organizativ —In 2018, Vullnetari i Korpusit të Paqes Ackeem dhe kolegët e tij nga bashkia zbatuan një projekt që lehtësoi një mundësi bashkëpunimi të pazakontë midis të rinjve të qytetit të tij dhe bashkisë.

Activitetet—Të rinj nga të gjitha 14 shkollat ne qytet punuan me bashkine për të zbuluar liqenin e tyre dhe krijuan hapësira për kopshte.

Ndikimi—Ky projekt siguroi një zë për të rinjtë në komunitet dhe do të promovojë investimet e ardhshme të të rinjve në qytet. Për më tepër, komuna kishte mundësinë dhe promovoi një mjedis më gjithëpërfshirës për transparencë.



*VKP Ackeem (ne mes)
me të rinj nga komuniteti i tij dhe
një kolege nga bashkia gjatë projektit.*

5,210

Individë, anëtarë të organizatave lokale ose komunitete u trajnuan në zhvillimin e organizimit (planifikimi, menaxhimi i brendshëm, menaxhimi i projekteve, komunikimi) dhe ndërtimi i shoqërisë civile (lidërsip, aftësitë profesionale, mësimi i shërbimit dhe vullnetarizmi, aftësitë e advokimit).

Libraria Amerikane hapet në Shkollën e Mesme vendore



Mësimdhënia e anglishtes— Jordan është një Vullnetar i Korpusit të Paqes i cili punon si mësues i anglishtes në shkollën e mesme të qytetit të tij. Ai, studentët e tij dhe kolegët mësues donin të transformonin një depo të madhe në një bibliotekë shkollore. Me ndihmën e mësuesve dhe drejtorit të shkollës, Jordani mobilizoi nxënësit si dhe komunitetin për të mbledhur mjete dhe për të lyer me bojë ambjentin për tu bërë gati për fillimin e projektit.

Aktivitetet—Pas më shumë se një viti, Jordani zbuloi “Bibliotekën Amerikane” në shkollën e tij, fiks në kohë për fillimin e vitit të ri shkollor. Më shumë se 500 libra në anglisht u siguruan nga organizata të shumta, duke përfshirë ato të dhuruara dhe të dërguara në Shqipëri nga njerëz të ndryshëm në Shtetet e Bashkuara.

Ndikimi— Nxënësit janë në gjendje të shfletojnë libra të të gjitha niveleve të gjuhës në kohën e lirë. Dhoma e rinovuar që nuk ishte përdorur më parë është tani një hapësirë funksionale e bibliotekës, që përhap kulturën amerikane.



*Libra nga
“Biblioteka Amerikane”
në shkollën e VKP Jordan në qytetin e tij pritës në Shqipëri.*

798 Mësues të angazhuar në bashkë-mësimdhënie dhe planifikim, në krijimin e burimeve, dhomave të burimeve dhe bibliotekave.

7,288 Nxënës mësuan anglisht në klasë dhe rritën pjesëmarrjen e tyre në aktivitete jashtëshkollore.

662 Anëtarë të komunitetit u angazhuan në aktivitete dhe projekte, në zhvillimin profesional dhe personal.

Shkolla e fshatit fiton vendin e parë në një konkurs riciklimi



Edukimi Shëndetsor—Laura, një mësuese vullnetare e Korpusit të Paqes, për edukimin shëndetsor në një fshat të vogël në Shqipërinë e Veriut, punoi me mësuesit dhe studentët e shkollës së saj për të krijuar produkte për një konkurs riciklimi të quajtur "Zero Mbetje." Ajo ndihmoi studentët të fitojnë vendin e parë për herë të parë në këtë konkurs rajonal.

Aktivitetet—Laura dhe studentët e saj në shkollë punuan shumë për këtë projekt. Të gjithë ishin të vendosur në punën e tyre; mësuesit ishin të pasionuar dhe përkrahës të projektit dhe përpjekjeve të studentëve. Laura tha, "Jam shumë krenare për shkollën time dhe punën që kemi realizuar!"

Ndikimi—Kjo ngjarje hapi rrugën për një fushatë të Edukimit Mjedisor për nxënësit e shkollës. Studentët u kënaqën duke krijuar gjëra të dobishme dhe interesante nga artikujt që normalisht hidhen.



Studentë nga shkolla e vullnetares Laura tregojnë lodrat dhe zbukurimet që kanë bërë prej materialeve të riciklueshme.

Aspekte nga 2018



KONFERENCA ME GJITHË VULLNETARËT

Konferenca, ku morën pjesë të gjithë vullnetarët që punonin në Shqipëri, dha informacion të dobishëm rreth ndikimeve të punës vullnetare në të gjithë vendin.

U ftuan shumë miq, të cilët interesohen për shërbimin dhe vullnetarizmin, përfshirë edhe kryebashkiakun e Tiranës Erion Veliaj; shkrimtarë dhe themelues të OJQ-ve, Elizabeth Gowing dhe Robert Wilton; Bruna Kuqi, pedagoge e kulturës amerikane në Universitetin e Tiranës; dhe shkrimtarja Vera Bekteshi, që ndau historinë e jetës së saj, duke përfshirë internimin, si dhe duke shpjeguar se si ajo e përballoi këtë periudhë të vështirë në historinë shqiptare.



“Ne jemi mirënjohës ndaj Katie, sepse ajo ka dhënë një kontribut të paçmuar për organizatën tonë dhe ne kemi qenë me fat që kemi pasur një person të tillë, pjesë të ekipit tonë.”



PROJEKTI I SHËRBIMIT

Korpusi i Paqes në Shqipëri, bashkë me Agjencinë e Parqeve të Tiranës dhe me të rinj shqiptarë, zhvilluan një projekt shërbimi në Parkun e Liqenit të Tiranës.



ZYRA E HAPUR PËR TU VIZITUAR

Korpusi i Paqes organizoi një pritje ku hapi Zyrat për tu vizituar nga partnerët.

Pas 20 vite punë në Shqipëri, Korpusi i Paqes ka shumë miq dhe partnerë në gjithë vendin. Vullnetaret nuk mundën ta bëjnë punën e tyre pa mbështetjen e partnereve nga komuniteti.

Korpusi i Paqes Shqipëria ishte i kënaqur që shumë nga partnerët vizituan zyrat e tij për herë të parë.



Fatmira, homologia e VKP Katie, Drejtoreshë e OJQ Porta Rome për Integrim.

Korpusi i Paqes Shqipëri ndan historitë e vullnetarëve në Facebook dhe Instagram



- Në 2018, ne patëm një arritje, arritëm në 6000 ndjekës në Facebook.
- Ne postuam 150 herë në 2018.
- Ne jemi duke arritur tek një popullsi në Shqipëri që është aktive dhe e shpejtë për t'u mobilizuar rreth një kauze si vullnetarizmi.
- Ne angazhojmë në Amerikë vullnetarë të mundshëm të Korpusit të Paqes që ndajnë me ne idealet e paqes dhe miqësisë botërore.

<https://www.facebook.com/albania.peacecorps>



- In 2018 Korpusi i Paqes në Shqipëri hapi një llogari në Instagram.
- Duke përdorur fuqinë e fotografive për të komunikuar ne po i vendosim një fytyrë organizatës sonë dhe po ndihmojmë gjithashtu instagrameerët e rinj të gjejnë mesazhin tonë.
- Instagrami ynë po rritet shpejt dhe ka arritur të ketë 820 ndjekës në vetëm 10 muaj.

[@peacecorpsalbania](https://www.instagram.com/peacecorpsalbania)

Programi i Granteve të Vogla 2018



“USAID/Shqipëri është krenar për partneritetin me Korpusin e Paqes / Shqipëri për të mbështetur aktivitetet e zhvillimit të komunitetit në nivel bazë duke bërë ndikime të jashtëzakonshme me angazhime minimale financiare.”

*Mikaela,
Drejtoreshë e
USAID Shqipëri*

Programi i Partneritetit i Korpusit të Paqes (PPKP)

PPKP vendos lidhje mes vullnetarëve e komuniteteve të tyre me sektorin privat në SH.B.A dhe nëpër botë për të financuar projekte të inicuar dhe drejtuara nga komunitetet.

\$18,500

Iu akorduan Korpusit të Paqes Shqiperi në 2018, duke financuar 7 projekte në 7 komunitete

Miqte e Shqiperisë (MSH)

MSH është një organizatë e krijuar nga ish vullnetarët e Korpusit të Paqes. Tani, MSH po siguron ndihmë për projektet vetë-ndihmuese, zhvillimore dhe arsimore komunitare në Shqipëri përmes granteve të vogla për vullnetarët aktual të Korpusit të Paqes që punojnë me organizatat lokale. ***Që prej fillimit të saj, MSH ka akorduar më shumë se \$10,000 grante për VKP të Shqipërisë dhe homologëve të tyre vendas.*** Në 2018, u financuan 16 projekte në 16 komunitete në gjithë Shqipërinë.

Asistenca e Projekteve të Vogla (APV)

Vështrim Përmbledhës

190

Projekte u financuan dhe zbatuan në Shqipëri që nga fillimi i programit në 2004

\$2,000–\$4,000

Rrezja e fondeve të gatshme për projekt përmes granteve APV

25%

Sasia e fondeve kontribut komunitar të kërkuara kundrejt projektit

Në 2018

\$27,649

Sasia e siguruar nga USAID/Shqipëri për grantet APV

10

Projekte të vogla komunitare u financuan

3

Seminare për manaxhimin dhe dizajnimin e projekteve u financuan për VKP-të dhe homologët e tyre

Organizata Partnere gjatë 2018



Organizatiata Jo-Qeveritare (OJQ)

- Agro-Puka
- American Councils
- ARKA Center—Shkodër
- CSDC Durrës
- Darien Book Aid
- Shoqata e Mësuesve të gjuhës angleze (ELTA)
- ESU –Unioni Anglishtfolës
- Fondacioni shqiptar për zhvillimin e kapaciteteve vendore
- Banka Ushqimore
- Miqte e Shqiperise
- Urat e Reja
- Mary Ward Loreto
- Agjensia Rajonale e Zhvillimit—Korçë
- Sidi Education
- Terre des Hommes
- Water Charity
- Shoqata Botërore e Vajzave Udhërrefyese dhe Skautiste
- World Connect
- World Vision
- Të Rinjtë e Urës
- Qendra Rinore—Vlorë
- Të Rinjtë në Sipërmarrje të Lirë
- Dibra Turistike

Bashkitë

- | | | |
|-----------|----------------|---------------|
| • Berat | • Kuçovë | • Bulqizë |
| • Elbasan | • Lushnje | • Klos |
| • Ersekë | • Ura Vajguore | • Librazhd |
| • Fier | • Mirditë | • Përmet |
| • Kavaje | • Roskovec | • Gjirokastrë |
| • Korçë | • Shijak | |
| • Krujë | • Fushë Arrëz | |

Organizata Qeveritare dhe të Pavarura

- Kryqi i Kuq Shqiptar
- Dhoma e Tregtisë—Vlorë
- Drejtorite e Shendetit Publik
- Instituti i Zhvillimit te Arsimit
- Instituti i Shendetit Publik
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
- Ministria e Shëndetsisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Projekti i Planifikimit dhe Qeverisjes Vendore
- Agjencie Rajonale të Zhvillimit të Vlorës, Korçës dhe Tiranës
- Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare—Gjirokastrë
- Drejtoria Rajonale e Shërbimeve Sociale Shtetërore—Berat
- Drejtoria Rajonale e Shërbimeve Sociale Shtetërore—Durrës
- Kombet e Bashkuara në Shqipëri
- Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullatën
- Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID)
- Ambasada e Shteteve të Bashkuara dhe Këndet Amerikane
- Universiteti i Tiranës, Departamenti i Gjuhës Angleze

Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore

- | | | |
|-----------|---------------|-------------------|
| • Berat | • Gjirokastrë | • Tiranë Qytet |
| • Dibër | • Korçë | • Tiranë Rajonale |
| • Durrës | • Kukës | • Vlorë |
| • Elbasan | • Lezhë | |
| • Fier | • Shkodër | |

Personeli ynë me kohë të plotë në 2018

Korpusi i Paqes në Shqipëri është krenar që ka një staf të përkushtuar të përbërë nga amerikanë dhe shqiptarë. Së bashku, ata i mbështesin vullnetarët tanë çdo ditë të vitit për t'i ndihmuar ata të përmbushin qëllimet e tyre të shërbimit. Në 2018, stafi ynë mbeti profesional dhe pozitiv gjatë Trajnimit të Para-Shërbimit për vullnetarët e rinj, një fushatë të bollshme me burime të ndryshme, për zhvillimin e përgatitjes së vendeve të punës për vullnetarët, mbylljen e procesit të shërbimit për grupin e vullnetarëve që përfunduan punën e tyre dhe zbatimin e politikave të reja që kërkonin punë shtesë - përveç përgjegjësi të tyre të rregullta. Përpjekjet e këtyre njerëzve e bëjnë Korpusin e Paqes në Shqipëri, postin e suksesshëm që ai është në të vërtetë.



Agim Dyrmishi
Alsida Myrtaj
Anida Tulo
Arben Cako
Arben Loci
Ardiana Brahja
Besa Arapi
Carmen Sheehan
Darina Kaltani
Diana Djaloshi
Dritan Gjoshi
Dritan Kamberi
Elsona Cupi
Gentian Leka
Gentian Mano
Ilir Memlikaj
Ilir Ziu
Iris Dollia
Iva Sinani

Kate Becker
Kyle Olsen
Lumturi Piciri
Marie Aughenbaugh
Marjeta Zavalani
Marsela Loci
Mira Luca
Mirela Tahiraj
Monika Mukja
Poleta Luka
Ylli Cupi



Personeli ynë i Trajnimit të Para-Shërbimit 2018

Çdo vit, Korpusi i Paqes në Shqipëri punëson 18 punonjës të përkohshëm për të luajtur një rol vendimtar në Trajnimin para Shërbimit (TPSH) të vullnetarëve tanë të rinj. Këta individë janë të përkushtuar ndaj idealeve dhe misionit të Korpusit të Paqes po aq sa dhe stafi ynë i rregullt. Ata janë pjesë e familjes sonë dhe çdo vit, kur përfundon TPHS, e kemi të vështirë t'i themi atyre mirupafshim. Ata i mësojnë vullnetarëve tanë një gjuhë të re, i mbajnë ata të sigurt, të shëndetshëm dhe të organizuar. Korpusi i Paqes në Shqipëri është ai që është sot edhe në sajë të përpjekjeve të tyre.



Ali Gjiriti
Alketa Canka
Besarta Stafa
Besmira Rrumbullaku
Bruna Çoku
Denisa Panxhi
Eglantina Reka
Elona Pajova
Erion Kumuria
Ervin Bebeti
Imelda Celibashi
Ledion Veshi
Sara Gaçe
Vjollca Merdani
Xheni Hatillari
Ymer Leksi
Zamir Mero
Zerina Zeneli



Korpusi i Paqes Shqipëri
Rr. Besnik Sykja, Godina 2
Hyrja 1, P.O. Box 8180
Tiranë, Shqipëri

Telefon: +355 42 365 5033

Email: AL-information@peacecorps.gov

Faqja në Internet:
peacecorps.gov/albania/

Facebook:
facebook.com/albania.peacecorps

Instagram:
Na kërkoni me [@peacecorpsalbania](https://www.instagram.com/peacecorpsalbania)